



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.63, datë 17.05.2024

PËR

**“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN
GENTI XHOLI, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM”**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a” dhe 189, pika 1, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 32 dhe nenin 48 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikën 5, të nenit 9, të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe germën “ç”, pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin Genti Xholi, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Genti Xholi, në kuadër të kandidimit për riemërim për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Genti Xholi të vijojë me procedurat e mëtejshme për riemërim në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
3. Të njoftohet për këtë vendim zoti Genti Xholi.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 17.05.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda